

VENDIM
Nr.1000, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SULT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sult të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sult të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.925, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sult të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sult për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Sult

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
11-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
14-45	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
46-59	Varrezat publike	Në pronësi
60-89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
351,353,355,356,359, 361,362	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produkteve)	Në përdorim
352,354,357,358,360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në përdorim
378-394,396-441	Infrastrukturë (rugë vendore)	Në pronësi
443	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi